

# STATISTIKAT E SHKAQEVE TË VDEKJEVE


2025

Gjatë vitit 2025, në Shqipëri u regjistruan 21.394 vdekje, duke shënuar një rënie prej 3,2 %, krahasuar me vitin 2024 (22.102 vdekje). Norma bruto e vdekshmërisë në vitin 2025 ishte 910,5 vdekje për 100 mijë banorë, përkundrejt 929,8 vdekje për 100 mijë banorë në vitin 2024.

## Shkaqet e vdekjeve në vitin 2025:

- 96,7 % e vdekjeve kanë ndodhur si pasojë e shkaqeve natyrale, duke shënuar një rënie prej 0,3 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2024;
- 2,2 % si pasojë e aksidenteve, duke shënuar një rritje prej 0,3 pikë përqindje;
- 0,2 % nga vrasjet, në të njëjtin nivel me vitin 2024;
- 0,9 % si pasojë e vetëvrasjeve, në të njëjtin nivel me vitin 2024.

**FIG.1 SHKAQET E VDEKJEVE SIPAS GRUP-SËMUNDJEVE KRYESORE, 2025 (NË %)**



## Vdekshmëria foshnjore

- Janë regjistruar 106 vdekje foshnjore në vitin 2025, nga 110 në vitin 2024.
- Në vitin 2025, norma e vdekshmërisë foshnjore është 4,7 për 1.000 lindje të gjalla, duke mbetur e pandryshuar, krahasuar me vitin 2024.

### Vdekshmëria sipas grup-sëmundjeve

- Sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut përbënin 52,9 % të totalit të vdekjeve në 2025, në të njëjtin nivel me vitin 2024. Brenda këtij grupi:
  - Sëmundjet kronike të zemrës: 42,2 %;
  - Sëmundjet ishemike të zemrës: 22,4 %;
  - Sëmundjet e enëve të trurit: 18,8 %.
- “Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë” zënë vendin e dytë të vdekjeve me 20,9 %. Brenda këtij grupi, vdekjet nga pleqëria përbëjnë 72,9 %.
- Grup-sëmundja “Tumore” renditet në vend të tretë. Brenda këtij grupi:
  - Tumoret malinje të aparatit të tretjes: 35,5 %
  - Tumoret malinje të aparatit të frymëmarrjes: 23,3 %
  - Tumoret malinje të organeve urogjenitale: 14,3 %

### Vdekshmëria sipas gjinisë

- Sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut përbëjnë shkakun kryesor të vdekjeve për të dyja gjinitë, duke zënë 54,5 % të vdekjeve te femrat dhe 51,6 % te meshkujt.
- Vdekjet nga pleqëria janë më të shpeshta te femrat sesa te meshkujt.
- Tumoret përbëjnë një shkak më të shpeshtë vdekjeje te meshkujt, duke përfaqësuar 17,5 % të vdekjeve te meshkujt, krahasuar me 12,8 % te femrat.

### Vdekshmëria sipas moshës

- Për grup-moshën 0-19 vjeç, sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut përbëjnë shkakun kryesor të vdekjeve, me 28,5 %, të ndjekura nga sëmundjet që shfaqen në periudhën rreth lindjes, me 22,2 %.
- Në grup-moshën 20-44 vjeç, dëmtimet traumatike dhe helmimet përbëjnë shkakun kryesor të vdekjeve, duke zënë 33,3 %, ndërsa sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut renditen të dytat me 30,1 %.

Për më shumë informacion dhe për të parë tabelat e detajuara, vizitoni bazën e të dhënave në faqen zyrtare të

INSTAT: [Shkaqet e vdekjeve](#)

# Metodologjia

## Të dhënat e shkaqeve të vdekjes

Të dhënat e vdekjeve sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile sipas karakteristikave bazë demografike dhe shkakut të vdekjeve. Këto të dhëna bazohen mbi informacionin e marrë nga "skedat e vdekjeve" të plotësuara nga mjeku. Më pas, të dhënat pastrohen dhe përpunohen duke analizuar një sërë variablash si: përshkrimin me fjalë të sëmundjes, moshën dhe gjininë e personit, si dhe bëhet kodifikimi i shkakut sipas klasifikimit ndërkombëtar ICD -9.

## Klasifikimi Ndërkombëtar i Sëmundjeve dhe Problemeve të Ndërlidhura me Shëndetin "ICD-9"

është klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve, i cili bën grupimin në mënyrë të koduar të 17 grupeve kryesore të sëmundjeve. Kodimi për shkaqet e vdekjeve bëhet nga mjeku dhe përbën burimin më të plotë zyrtar statistikor të sëmundjeve që janë shkak i vdekjes.

### Koncepte:

**Shkaku i vdekjes** është sëmundja ose simptoma që ka shkaktuar ose kontribuar në vdekje, si dhe rrethanat e aksidentit që kanë shkaktuar këto trauma (përshkruhet në certifikatën e vdekjes).

**Vdekja** nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha funksioneve vitale dhe pamundësinë e reanimimit në çdo kohë pas një lindjeje të gjallë. Ky përkufizim nuk përfshin vdekjen fetale.

**Shkalla e vdekshmërisë foshnjore** tregon raportin e numrit të vdekjeve për fëmijët nën moshën 1 vjeç gjatë vitit me numrin e lindjeve të gjalla të atij viti, i shprehur për 1.000 lindje të gjalla.

**Vdekje aksidentale** janë vdekjet të shkaktuara nga shkaqe të jashtme dhe përfshijnë aksidente të qarkullimit rrugor, aksidente të transportit ujor, aksidente hekurudhore, aksidente në punë, aksidente nga zjarri, rënie, rrëzime-aksidentale, aksidente nga veprues fizik të natyrshëm ose faktorë të mjedisit dhe aksidente të tjera.

**Burimi i të dhënave:** Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.